



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DREJTORIA E FINANCËS

**INVESTIMET NË INFRASTRUKTURËN ARSIMORE
2014-2016**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështet ndertimin/rehabilitimin e infrastrukturës arsimore ne programet e arsimit baze, arsimit të mesëm të pergjithshem adhe atij universitar, përmes financimit të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe Institucioneve të arsimit të lartë.

Referuar Aneksit 3 të Ligjit të buxhetit, Njësitë e qeverisjes vendore dhe Institucionet e arsimit të lartë, aplikojnë me projekte pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për të përfituar financime përmes Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Shpërndarja e financimit dhe menaxhimi i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

1. Kryeministrin Kryetar
2. Zëvendëskryeministrin Zëvendëskryetar;
3. Ministrin e Financave anëtar;
4. Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes anëtar
5. Ministrin e Zhvillimit Urban anëtar;
6. Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës anëtar;
7. Ministrin e Arsimit dhe Sportit anëtar;
8. Ministrin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave anëtar;
9. Ministrin e Shëndetësisë anëtar;
10. Ministrin e Kulturës anëtar;
11. Ministrin e Mjedisit anëtar;
12. Ministrin e Punëve të Brendshme anëtar;
13. Ministrin e Shtetit për Inovacionin 1 dhe Administratën Publike anëtar;
14. Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore anëtar; 1

5. Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë anëtar;
16. Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore anëtar;
17. Kryetarin e Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë anëtar;
18. Përfaqësuesin e Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal 1 anëtar;
19. Përfaqësuesin e Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal 2 anëtar;
20. Përfaqësuesin e Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal 3 anëtar;
21. Përfaqësuesin e Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal 4 anëtar;

Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është pranë Kryeministrit, Njësia e Planifikimit Strategjik, si pjese e Departamentit të Zhvillimit dhe Ndhimes së Huaj.

Tre janë prioritetet kryesore të zhvillimit të arsimit në fushën e investimeve në infrastrukturën arsimore.

1. Ulja e numrit të nxënësve për klasë (jo më shumë se 30 nxënës për klasë) dhe kthimi i sistemit arsimor me 1 turn, objektiv i cili arrihet nëpërmjet zgjerimit të infrastrukturës arsimore ekzistuese në zonat urbane me rritje popullore (ndërtim objekte të reja dhe zgjerim i atyre ekzistuese)
2. Kthimi i objekteve arsimore në qendra komunitare përmes zgjerimit të terreneve sportive dhe krijimit të sallave të internetit në shkolla në ndihmë të komunitetit.
3. Ndërtohet sistemi që mundëson gjithëpërfshirjen e nxënësve në arsimin bazë të detyrueshëm, i ndjeshëm ndaj nevojave të nxënësve të shtresave në nevojë dhe të disavantazuara. Kjo nëpërmjet krijimit të kushteve normale të mësimin të godinave të qëndrueshme me ngrohje dhe kushte normale për zhvillimin e mësimin.

Në mbështetje të këtyre objektivave, çdo vit, Ministria e Arsimit dhe Sportit jep kontributin e saj në përcaktimin e prioriteteve dhe projekteve që mbështeten me fonde nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve apo në mundësi të tjera financimi nga donator të ndryshëm apo projekte zhvillimore.

Në kontekstin e legjislacionit në fuqi, financimi nga buxheti i shtetit planifikohet me formulën “për nxënës”, sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve të institucioneve arsimore publike. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve infrastrukturore (godina, ndërtim/riaftësim, mirëmbajtje, ruajtje, sigurim dhe garantim i funksionimit të shërbimit arsimor, si ujë, elektricitet etj.) për të gjithë nxënësit në Institucionet arsimore publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë periudhës 2014-2016, MAS ka mundësuar përmes buxhetit të saj, financimin e infrastrukturës arsimore (ndërtime të reja, shtesa objektesh dhe rehabilitime) për **128 projekte të reja** me vlerë totale investimi 5 miliardë e 630 milionë lekë në arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë (kopshte, shkolla të arsimit 9-vjecar, të mesëm dhe Institucione të arsimit të lartë) si dhe rehabilitimin e 43 terreneve sportive me vlerë totale investimi 274 milionë leke në 12 qarqe të vendit.


Gjithashtu, gjatë këësaj periudhe janë financuar detyrimet për kontrata në vazhdim (objekte infrastrukturore të miratuara nga Fondi I Zhvillimit të Rajoneve **në periudhën 2012-2013**, por që nuk ishin financuar në masën 100% (ishte financuar vetëm 20% -30% e vlerës së kontratave

- Në vitin 2014 janë financuar 116 projekte/kontrata, të cilat u shlyen përmes financimit shtesë nga strategjia e likuidimit të borxheve, në shumën 927,4 milionë lekë.
- Në vijim, në vitin 2015 janë financuar 29 kontrata/projekte në vazhdim, me vlerë financimi 312,3 milionë lekë, që i përkasin projekteve të periudhës 2012-2013.
- Në vitin 2016, u financuan 20 projekte me vlerë 230 milionë lekë, projekte të periudhës 2012-2013.


Përmes shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka bërë të mundur që të përmbillë të gjithë detyrimet e prapambetura, duke mos trashëguar asnjë borxh të prapambetur për projekte investimesh. Në vitin 2017, përmes buxhetit 2017, MAS do të financojë vetëm projektet në vazhdim nga viti 2016 dhe projekte të reja të infrastrukturës, duke mos trashëguar asnjë detyrim të prapambetur.

Paraqitja grafike sipas NJQV për objektet arsimore dhe terrenet sportive të reja, të financuara në periudhën 2014-2016, ilustron në grafikët më poshtë:


Grafik 1. Numri i objekteve arsimore sipas qarqeve



Grafik 2. Shpërndarja e financimit për objektet arsimore sipas qarqeve



Grafik 3. Numri I terreneve sportive të ndërtuar/rehabilituar sipas qarqeve



Portofoli I Investimeve për periudhën 2014-2016, i detajuar në nivel qarku.

QARKU BERAT

Projekti "Shkolla, qendër komunitare" Bashkia Berat

Ndërtimi 3 fushave sportive polifunkionale në ambientet e shkollave "Ajet Xhindoli", lagjia Muzakaj; Shkolla "28 Nëntori", dhe shkolla "Xhemal Çekini"

Ky projekt është në mbështetje të arritjes së objektit për krijimin e shkollave si qendër komunitare për zonën ku ushtron aktivitetin si e tillë. Fushat sportive do të shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve sportive të nxënësve dhe të banorëve të zonës ku ndodhet shkolla.

Pozicioni	Bashkia Berat
Përshkrimi Teknik	Ndërtim terrene sportive brenda oborreve të shkollave
Vlera e Veprës	7,424,000 Lekë
Afati i Punimeve	2014 – 2015

.....

Shkolla 9 vjeçare "Thimi Tani" Berat

"Gjendja e rënduar e shkollës nga mungesa e investimeve prej vitesh dhe mirëmbajtja e dobët e saj ka bërë që të parashtrohet si emergjencë kryerja e rikonstruksionit të plotë të objektit".

Pozicioni	Bashkia Berat
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plotë,
Vlera e Veprës	24,334,872 Lekë
Afati i Punimeve	2014 – 2015

.....

Shkolla e mesme "Kristaq Capo"

Ky gjimnaz ka një numër të konsiderueshëm nxënësish dhe paraqet domosdoshmëri për kryerje të rikonstruksionit të plotë të saj.

Pozicioni	Bashkia Berat
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plotë,
Vlera e Veprës	26.255.240 Lekë
Afati i Punimeve	2014 -2015

.....

Shkollë+kopësht, Karkanjuz, Njësia Administrative Roshnik – Berat

Shkolla ekzistuese paraqitet rrezik shëmbje dhe në këtë zonë ka mungesë godine për kopësht fëmijësh. Paraqitet si domosdoshmëri ndërtimi i një shkolle të re dhe brenda shkollës ndërtimi i mjedisit të kopështit me hyrje më vete nga shkolla.

Pozicioni	Njësia Administrative Roshnik, Berat
Përshkrimi Teknik	Ndërtim i Ri
Vlera e Veprës	19.929.917 Lekë
Afati i Punimeve	2014 – 2015

“Shkolla e Bashkuar, Lagja "4 Shtatori", Ura Vajguore” – Berat

Ështëshkollë me numër të konsiderueshëm nxënësish të cilët nuk kanë mjedise për zhvillimin e mësimin të edukimit fizik. Është ndërtuar palestër për shkollën e cila do të shërbejë dhe për komunitetin si dhe janë kryer punime rrethimi dhe sistemimi me mendimin që oborri i shkollës të mos kryejë funksionin si rrugë kalimi për lagjen por si një oborr funksional për shkollën dhe komunitetin e zonës.

Pozicioni	Lagja "4 Shtatori", Bashkia Ura Vajguore”, Berat
Përshkrimi Teknik	Sistemim, rrethim oborri, ndërtim palestere
Vlera e Veprës	24.317.111 Lekë
Afati i Punimeve	2015 – 2016

.....

Shkolla 9-vjecare "Andrea Mbrice" Poshnje, Berat

Shkolla paraqet probleme në gjëndjen fizike të saj në funksionimin e nyjeve hidrosanitare, në sistemin elektrik në muret me lagështi etj. Ka të domosdoshme ndërhyrjen e investime për kthimin e saj në gjëndjen normale dhe sigurimin e sistemit qëndror të ngrohjes në të.

Pozicioni	Njësia Administrative Poshnjë Berat.
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plotë dhe sistem qëndror ngrohje
Vlera e Veprës	52,710,346 Lekë
Afati i Punimeve	05.09.2016- 05.01.2017

.....

Shkolla 9 vjeçare Zaloshnje, Skrapar

Shkolla paraqet probleme në funksionimin e nyjeve hidrosanitare dhe sistemin e çatisë

Pozicioni	Njësia Administrative Gjerbës, Bashkia Skrapar
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i pjesshëm
Vlera e Veprës	5.406.377 Lekë
Afati i Punimeve	2014 -2015

.....

QARKU DIBER

Shkolla 9 vjeçare Gjoricë, Njësia Administrative Gjoricë, Bulqizë

Shkolla paraqitet e amortizuar dhe ka nevojë për rikonstruksion të plotë. Për numrin e nxënësve që ka kjo shkollë dhe për kushtet atmosferike në dimër në këtë zonë është e domosdoshme dhe ndërtimi i një palestere për zhvillimin e mësimit të edukimit fizik.

Pozicioni	Njësia Administrative Gjoricë, Bulqizë
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plotë dhe ndërtim palestër e re
Vlera e Veprës	46.785.110 Lekë
Afati i Punimeve	2014 -2015

.....

Shkolla e Mesme Shupenze dhe Shkolla 9-vjeçare “Ibrahim Daci”, Njësia Administrative Shupenzë, Bulqizë

Shkollat paraqisnin probleme në lidhje me nyjet hidrosanitare shtresat instalimet elektrike , dhe problemet e lagështisë. Shkolla mesme Shupenzë është shkolla më e madhe e zonës dhe është përfshirë në projektin e shkollave si qendër komunitare. Për këtë arsye është parashikuar dhe krijimi i terreneve sportive. Shkolla 9 vjeçare “Ibrahim Daci” ka nevojë për rikonstruksion të plotë pasi paraqitet e amortizuar. Rikonstruksioni i ketij objekti behet i domosdoshem si rezultat i degradimit të suvasë, instalimeve elektrike dhe hidraulike, mungesës së mjediseve të shërbimit nënyjet hidrosanitare, prezencës së lagështisë së vazhdueshme të faqeve të themeleve, degradimit të shtresës së pllakave, mungesës së rrethimit të territorit të shkollës, mungesës së kanalizimeve të ujrave të zeza etj.

Pozicioni	Njësia Administrative Shupenzë, Bulqizë
Përshkrimi Teknik	Shkolla Shupenzë Rikonstruksion i plotë dhe palestër e re. Shkolla “Ibrahim Daci” rikonstruksion i plote dhe shtesë klasash
Vlera e Veprës	86.808.744 Lekë
Afati i Punimeve	19.09.2016 – 19.03.2017

.....

Projekti "Shkolla Qendër Komunitare" Terrene sportive në shkollat e Bashkisë Peshkopi, Dibër

Ndërtimi4 fushave sportive polifunkionale në mjediset e shkollave "Nazmi Rushiti", Shkolla "Demir Gashi", shkolla " Seit Najdeni" dhe shkolla "Selim Alliu" Bashkia Peshkopi.

Ky projekt është në mbështetje të arritjes së objektit për krijimin e shkollave si qendër komunitare për zonën ku ushtron aktivitetin si e tillë. Fushat sportive do të shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve sportive të nxënësve dhe të banorëve të zonës ku ndodhet shkolla.

Pozicioni	Bashkia Peshkopi
Përshkrimi Teknik	Ndërtim terrene sportive brenda oborreve të shkollave
Vlera e Veprës	31.174.406 Lekë
Afati i Punimeve	2015-2016

.....

Shkolla e mesme Maqellarë

Shkolla e mesme ka zhvilluar mësimin në ambientet e shkollës 9 vjeçare. Rritja e numrit të fëmijëve në këtë zonë si dhe e përqindjes së fëmijëve të zonës që duan të ndjekin shkollën e mesme ka nxjerrë të domosdoshme ndërtimin e shkollës së mesme si godinë më vete,

Pozicioni	Njësia Administrative Maqellarë, Dibër
Përshkrimi Teknik	Ndërtim i ri me 12 klasë me sistem ngrohje
Vlera e Veprës	94.767.154 Lekë
Afati i Punimeve	2016 e vazhdim

.....

Shkolla 9 vjeçare Radomirë

Shkolla ekzistuese është e amortizuar dhe ka nevojë për rikonstrukcion të plotë. Meqënëse objekti ndodhet në zonë të thellë malore me dimër të gjatë për zhvillimin e mësimin të edukimit fizik del e domosdoshme ndërtimi i një palestere.

Pozicioni	Njësia Administrative Kala e Dodës, Dibër
Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion dhe ndërtim palestere
Vlera e Veprës	38,042,771Lekë
Afati i Punimeve	06.10.2014 –14.12.2014

Shkolla mesme e bashkuar Xibër.

Shkolla ekzistuese është rrezik shëmbje dhe paraqiste rrezik për jetën e fëmijëve për efekt të rreshqitjes së truallit ku ishte vendosur shkolla, Ishte domosdoshmëri ndërtimi i shkollës së re në zonë jo rrëshqitëse

Pozicioni	Njësia Administrative Xibër, Mat
Përshkrimi Teknik	Ndërtim shkollë e re me 12 klasë
Vlera e Veprës	55.193.734 Lekë
Afati i Punimeve	Shtator 2014 –Korrik 2015

.....

Shkolla e mesme e bashkuar “Abdyrrahman Përmeti” Lis.

Shkolla ekzistuese është e amortizuar. Parashikohen të kryhet rikonstrukcion i plotë dyer dritare shtresa nyje hidrosanitare instalime elektrike etj. Kërkohet rikonstrukcion i plotë.

Pozicioni	Njësia Administrative Lis, Mat
Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion dhe përforcim konstruksioni
Vlera e Veprës	23,169,907 Lekë
Afati i Punimeve	shtator 2014 –dhjetor 2014

.....

QARKU DURRËS

Shkolla 9-vjeçare Nr.4, Krujë, Bashkia Kruje.

Shkolla ekzistuese është e amortizuar. Parashikohen të kryhet rikonstrukcion i plotë dyer dritare shtresa nyje hidrosanitare,instalime elektrike etj. Kërkohet rikonstrukcion i plotë.

Pozicioni	Bashkia Krujë
Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion dhe shtesë klasa për kthim të shkollës me 1 turn
Vlera e Veprës	56,546,095 Lekë
Afati i Punimeve	2014 –dhjetor 2015

.....

Shkolla e mesme Skënderbej, Krujë, Bashkia Krujë.

Shkolla ekzistuese është e amortizuar Parashikohen të kryhet rikonstrukcion i plotë dyer dritare shtresa nyje hidrosanitare,instalime elektrike, sistem ngrohje si dhe sistemime të jashtme terrrne sportive.

Pozicioni	Bashkia Krujë
-----------	---------------

Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion system ngroje dhe sistemim terrene sportive
Vlera e Veprës	25.501.820 Lekë
Afati i Punimeve	2015 –2016

.....

Palestër Shkolla 9-vjeçare Nr.4, Krujë, Bashkia Krujë.

Shkolla ekzistuese nuk ka palestër. Për numrin e fëmijëve që ka kjo shkollë për kryerjen e procesit mësimor të edukimit fizik ka të domosdoshme ndërtimin e palestrës.

Pozicioni	Bashkia Krujë
Përshkrimi Teknik	Ndërtim palestere shkolla 9 vjeçare nr 4
Vlera e Veprës	31,296,264 Lekë
Afati i Punimeve	2015 -2016

.....

Shkollae mesme "Ramazan Karaj", Nikel, Njësia Administrative Nikël.

Shkolla ekzistuese është e amortizuar. Parashikohen të kryhet rikonstrukcion i plotë dyer dritare shtresa nyje hidrosanitare, instalime elektrike etj. Kërkohet rikonstrukcion i plotë.

Pozicioni	Njësia Administrative Nikel, Krujë
Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion dhe përforcim konstruksioni
Vlera e Veprës	27.952.323 Lekë
Afati i Punimeve	2014 –2015

.....

Shkolla e mesme "Shote Galica" Njësia Administrative Fushë Krujë, Krujë

Shkolla ekzistuese ka aktualisht mbi 35 nxënës për klasë dhe ka në totale mbi 2000 nxënës. Ka të domosdoshme ndërtimin e godinës së re për uljen e numrit të nxënësve për klasë

Pozicioni	Njësia Administrative Fushë Krujë, Krujë
Përshkrimi Teknik	Ndërtim i ri
Vlera e Veprës	163.231.283 Lekë
Afati i Punimeve	2014 –2015

.....

Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Shkolla "Marie Kaçulini", shkolla 9 vjeçare "14 Nëntori", shkolla 9 vjeçare "Jusuf Puka", shkolla 9 vjeçare "Jani Kukuzeli", Bashkia Durrës

Ndërtimi4 fushave sportive polifunksionale në ambientet e shkollave "Marie Kaçulini ", Shkolla '14 Nëntori ", shkolla "Jusuf Puka" dhe shkolla "Jani Kukuzeli "

Ky projekt është në mbështetje të arritjes së objektit për krijimin e shkollave si qendër komunitare për zonën ku ushtron aktivitetin si e tillë. Fushat sportive do të shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve sportive të nxënësve dhe të banorëve të zonës ku ndodhet shkolla

Pozicioni	Bashkia Durrës
Përshkrimi Teknik	Ndërtim fusha sportive dhe minikalçeto
Vlera e Veprës	19.241.718 Lekë
Afati i Punimeve	2014 –2015

.....

Shkolla 9 vjeçare "Bajram Curri" Durrës

Shkolla ekzistuese Bajram Curri është amortizuar plotësisht. Kërkohej rikonstruksion i plotë sistem ngrohje veshje godine me sistem kapot për ruajtjen e energjisë në ndërtesë.

Pozicioni	Bashkia Durrës
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plotë sistem ngrohje dhe sistem kapot
Vlera e Veprës	96,564,458 Lekë
Afati i Punimeve	14.12.2015-14.10.2016

.....

Shkolla 9-vjeçare "Marie Kaculini", Durrës

Shkolla ekzistuese është e amortizuar. Parashikohen shëmbja e shkollës ekzistuese dhe ndërtimii një shkolle të re e ndërtuar sipas standarteve të ndërtimit të shkollave në fuqi.

Pozicioni	Bashkia Durrës
Përshkrimi Teknik	Ndërtim i ri
Vlera e Veprës	103.318.260 Lekë
Afati i Punimeve	13.01.2017

.....

Shkolla 9 vjeçare Shtrazë, Njësia administrative Gjepalaj, Durrës

Shkolla ekzistuese është rrezik shëmbje. Parashikohen të kryhet ndërtim i ri shkollë e re me 9 klasë sipas standarteve për ndërtimet arsimore në fuqi.

Pozicioni	Njësia Administrative Gjepalaj, Durrës
Përshkrimi Teknik	Ndërtim i ri sipas standarteve
Vlera e Veprës	46,145,342 Lekë
Afati i Punimeve	15.08 2016 –15.10.2016

QARKU ELBASAN

Shkolla 9-vjeçare "Halit Uruci" Belsh, Bashkia Belsh

Shkolla ekzistuese me amortizim të plotë. Kishte nevojë për rikonstruksion të plotë, suvatime shtresa ,instalime elektrike, instalime hidraulike, sistem ngrohje etj.

Pozicioni	Bashkia Belsh, Elbasan
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plotë sistem ngrohje , rrjet elektrik , hidraulik , punime sistemimi etj.
Vlera e Veprës	59.762.348 Lekë
Afati i Punimeve	2014-2015

.....

Projekti "Shkolla, qender komunitare", Bashkia Elbasan

Ndërtimi4 fushave sportive polifunkionale në ambientet e shkollave "Naim Frashëri", Shkolla 'Sul Harri", shkolla "Abdyl Paralloi" dhe shkolla "Adem Krasniqi".

Ky projekt është në mbështetje të arritjes së objektit për krijimin e shkollave si qendër komunitare për zonën ku ushtron aktivitetin si e tillë. Fushat sportive do të shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve sportive të nxënësve dhe të banorëve të zonës ku ndodhet shkolla

Pozicioni	Bashkia Elbasan
Përshkrimi Teknik	Ndërtimi i terrreneve sportive dhe mini kalçetove ne 4 shkollat
Vlera e Veprës	32.376.545 Lekë
Afati i Punimeve	2014-2015

.....

Shkolla 9-vjeçare "Xhafer HAKANI", Bashkia Elbasan

Kërkohej përfundimi i punimeve të rikonstruksionit për këtë godinë për ta kthyer në kushte normale mësimi.

Pozicioni	Bashkia Elbasan
Përshkrimi Teknik	Përfundimi i rikonstruksionit të godinës
Vlera e Veprës	11.987.760 Lekë
Afati i Punimeve	2014 - 2015

.....

Shkolla 9-vjeçare "Qamil Guranjaku" Bashkia Elbasan

Shkolla ishte e amortizuar. Janë parashikuar rikonstruksioni i plotë i godinës sistemi i ngrohjes .sistemi i ri elektrik, hidraulik, sistemi kapot për të siguruar ruajtjen e energjisë në ndërtesa, punime rikonstruksioni në palestër si dhe punime sistemimi oborri

Pozicioni	Bashkia Elbasan
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plotë, sistem ngrohje etj
Vlera e Veprës	65.448. 856 Lekë
Afati i Punimeve	Tetor 2016- Dhjetor 2016

.....

Shkolla 9-vjeçare "7 Marsi" Cërrik, Elbasan

Objekti kishte nevojë për ndërhyrje me investime në rrjetin elektrik hidraulik, si dhe në sistemin e ngrohjes. Gjithashtu objekti nuk kishte palestër dhe për të zhvilluar procesin e mësimin të edukimit fizik ishte e domosdoshme ndërtimi i palestrës për shkollën

Pozicioni	Bashkia Cërrik, Elbasan
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion godine, sistem ngrohje dhe ndërtim palestere
Vlera e Veprës	51.300.000 Lekë
Afati i Punimeve	2015-2016

.....

Shkolla 9-vjeçare "Adem Elmaz Asllani" Shtëpanjë, Elbasan

Shkolla ekzistuese ishte rrezik shëmbje. U mendua për ndërtim shkolle të re sipas standardeve në fuqi për shkollat. Gjithashtu është menduar dhe për ndërtim palestere për shkollën si dhe terren i hapur sportive. Shkolla është parashikuar me sistem ngrohje, terrene sportive etj

Pozicioni	Njësia Administrative Gostimë, Bashkia Cërrik, Elbasan
Përshkrimi Teknik	Ndërtim shkolle palestere dhe terrene sportive
Vlera e Veprës	72,948,120 Lekë
Afati i Punimeve	Nëntor 2016 e vazhdim

.....

Palestra e shkollës mesme "Shefqet GUZI" Gramsh,

Palestra ekzistuese e shkollës ishte në gjëndje të amortizuar dhe kishte nevojë për rikonstruksion, zëvendësim parketi , suvatime , instalime elektrike dhe hidraulike si dhe punime tarace

Pozicioni	Bashkia Gramsh
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion palestere

Vlera e Veprës 2,134,834 Lekë
Afati i Punimeve 2015 -2015

.....

Shkolla e mesme e bashkuar "Çaush Senja" Tunjë

Shkolla ekzistuese kishte çatinërrezik shëmbje. U mendua për ndërtim tëri çatie dhe punime rikonstruksioni brënda në godinë

Pozicioni Njësia Administrative Tunjë, Gramsh
Përshkrimi Teknik Rikonstruksion
Vlera e Veprës 4,541,584 Lekë
Afati i Punimeve 2015-2016

.....

Kopësht Nr 2 -Bashkia Librazhd,

Kopshti I qytetit të Librazhdit ishte i amortizuar dhe kishte nevojë për rikonstruksion

Pozicioni Bashkia Librazhd
Përshkrimi Teknik Rikonstruksion
Vlera e Veprës 8.763.720 Lekë
Afati i Punimeve 2016-2016

.....

Shkolla 9-vjeçare "Gurakuq" Njësia Administrative Rinas, Librazhd

Shkolla ekzistuese ishte rrezik shëmbje . U mendua për ndërtim shkolle tëre sipas standarteve në fuqi për shkollat

Pozicioni Njësia Administrative Rinas, Librazhd
Përshkrimi Teknik Ndërtim shkolle e re
Vlera e Veprës 10.566.046 Lekë
Afati i Punimeve 05.10.2016- 25.11.2016

.....

Shkolla mesme e bashkuar "Muharrem Zela" Kukur, Gramsh,

Shkolla ekzistuese ishte e amortizuar .Kishte nevojë për rikonstruksion mbulese, dyer dritare, suvatime e shtresa, instalime elektrike dhe hidraulike.

Pozicioni Njësia Administrative Kukur, Gramsh
Përshkrimi Teknik Rioknstruksion godine

Vlera e Veprës 20.934.861 Lekë
Afati i Punimeve 2014-2015

.....

Shkolla 9 vjeçare “Asllan Shahini, Gramsh,

Shkolla ekzistuese ishte e amortizuar.Është parashikuar rikonstruksion mbulese , dyer dritare, suvatime e shtresa, instalime elektrike dhe hidraulike, punime sistemimi e gjelbërimi, rrjeti telefonik dhe internetit etj

Pozicioni Bashkia Gramsh
Përshkrimi Teknik Rikonstruksion godine
Vlera e plote e projektit 55.024.983 Lekë
Afati i Punimeve Nuk ka përfunduar procedura e prokurimit

.....

Shkolla Fillore Urakë, Librazhd,

Shkolla ekzistuese ishte rrezik shëmbje . U mendua për ndërtim shkolle të re sipas standarteve në fuqi për shkollat

Pozicioni Njësia Administrative Rrajcë
Përshkrimi Teknik Ndërtim shkolle ere
Vlera e Veprës 5.803.069 Lekë
Afati i Punimeve 2014-2015

.....

Shkolla Fillore Zdrajsh Vërri, Orenjë,

Shkolla ekzistuese ishte rrezik shëmbje . U mendua për ndërtim shkolle të re sipas standarteve në fuqi për shkollat.

Pozicioni Njësia Administrative Orenjë, Librazhd
Përshkrimi Teknik Ndërtim shkolle e re
Vlera e Veprës 4.134.909 Lekë
Afati i Punimeve 2014-2014

.....

Shkolla 9-vjeçare Fushë Stude, Streblevë

Shkolla ekzistuese ishte në ambient të adoptuar dhe jashtë kushteve teknike për shkollë. U mendua për ndërtim shkolle të re sipas standarteve në fuqi për shkollat.

Pozicioni	Njësia Administrative Streblevë, Librazhd
Përshkrimi Teknik	Ndërtim shkolle e re me 7 klasë
Vlera e Veprës	16,595,565 Lekë
Afati i Punimeve	2014-2015

.....

Shkolla 9-vjeçare Babje , Qendër Librazhd

Shkolla ekzistuese ka çatinë e amortizuar si dhe instalimet elektrike dhe nyjet hidrosanitare. U mendua për të kryer rikonstrukcion të pjesshëm të saj

Pozicioni	Njësia Administrative Qendër, Librazhd
Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion i pjesshëm
Vlera e Veprës	6.448.248 Lekë
Afati i Punimeve	2014-2014

.....

Shkolla 9-vjeçare "Naim Frashëri " Pishkash, Qukës Librazhd

Shkolla ekzistuese ka çatinë e amortizuar, dyer dritare, instalimet elektrike dhe nyjet hidrosanitare . U mendua për të kryer rikonstrukcion të pjesshëm të saj

Pozicioni	Njësia Administrative Qukës, Librazhd
Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion i pjesshëm
Vlera e Veprës	9.591.133 Lekë
Afati i Punimeve	2014-2014

.....

QARKU FIER

Projekti "Shkolla, qender komunitare"

Ndërtimi 4 fushave sportive polifunkionale në ambientet e shkollave "Jani Bakalli", Shkolla "Liri Gero", shkolla "Kristaq Gero" dhe shkolla "Pinellopi Pirro".

Ky projekt është në mbështetje të arritjes së objektit për krijimin e shkollave si qendër komunitare për zonën ku ushtron aktivitetin si e tillë. Fushat sportive do të shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve sportive të nxënësve dhe të banorëve të zonës ku ndodhet shkolla.

Pozicioni	Bashkia Fier
Përshkrimi Teknik	Ndërtim terrene sportive dhe minikalçeto brenda oborrit të shkollave
Vlera e Veprës	13.497.107 Lekë
Afati i Punimeve	17.10.2014-15.02.2015

.....

Shkolla e mesme "Janaq Kilica" Fier,

Shkolla kishte nevojë për rikonstruksion dyer dritare shtresa nyje hidrosanitare dhe instalime elektrike

Pozicioni	Bashkia Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksioni mjediseve të brëndshme në godinë
Vlera e Veprës	27.165.114 Lekë
Afati i Punimeve	2015-2016

.....

Shkolla 9-vjeçare "Andon Xoxa" Fier,

Shkolla ekzistuese ishte e amortizuar në dyer dritare , shtresa, instalime elektrike dhe hidraulike, suvatime etj . U mendua për rikonstruksion të plotë të saj.

Pozicioni	Bashkia Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote dhe punime sistemimi dhe terrene sportive
Vlera e Veprës	33.315.328 Lekë
Afati i Punimeve	17.10.2014- 15.02.2015

.....

Shkolla 9-vjeçare "Jani Bakalli" Fier,

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për rikonstruksion. U bë zëvendësim dyer dritare, shtresa, zëvendësim rrjeti elektrik dhe hidraulik.

Pozicioni	Bashkia Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës
Vlera e Veprës	22.107.000 Lekë
Afati i Punimeve	19.10.2014- 15.02.2015

.....

Shkolla e mesme "Perikli Ikonomi" Fier,

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për rikonstruksion. U bë zëvendësim dyer dritare, shtresa, zëvendësim rrjeti elektrik dhe hidraulik.

Pozicioni	Bashkia Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës
Vlera e Veprës	43.090.920 Lekë
Afati i Punimeve	2016 e vazhdim

.....

Shkolla 9-vjecare "Dino Ismaili" Levan, Fier

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për rikonstruksion .Është parashikuar zëvendësim dyer dritare, shtresa, zëvendësim rrjeti elektrik dhe hidraulik, riparimi i catisëekzistuese , sistemimi i oborrit të jashtëm , shtimi i nyjeve hidrosanitare etj

Pozicioni	Njësia Administrative Levan ,Bashkia Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës
Vlera e Veprës	24.133.740 Lekë
Afati i Punimeve	2016 e vazhdim

.....

Shkolla 9-vjecare "Ymer XHAFÄ"Dermentas, Fier

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për rikonstruksion .Kërkohet të bëhen zëvendësim dyer dritare, shtresa, zëvendësim rrjeti elektrik dhe hidraulik.

Pozicioni	Njësia Administrative Dermentas Bashkia Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës
Vlera e Veprës	22.170.855 Lekë
Afati i Punimeve	2016 e vazhdim

.....

Shkolla e mesme "Zhani Ciko" Patos, Fier

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për rikonstruksion . U bë zëvendësim dyer dritare, shtresa, zëvendësim rrjeti elektrik dhe hidraulik.

Pozicioni	Bashkia Patos, Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës
Vlera e Veprës	42.966.761 Lekë
Afati i Punimeve	2014-2015

.....

Shkolla 9-vjeçare Strum, shkolla CU Arapaj dhe shkolla 9 vjeçare Naun DOKO, Roskovec

Shkollat ekzistuese kishin nevojë për rikonstruksion dhe ndertim të tualeteve brenda mjediseve shkollore. U bë rikonstruksioni dhe ndërtimi i tualeteve në shkollat e kësaj njësie bashkiake

Pozicioni	Bashkia Roskovec, Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksioni dhe ndërtim i tualeteve brenda mjediseve shkollore
Vlera e Veprës	12.676.088 Lekë
Afati i Punimeve	25.10.2016 25.11.2016

.....

Shkollë 9 vjeçare Sheq Musalalaj , Frakull, Fier

Shkolla ishte e amortizuar plotësisht, taraca , dyer dritare shtresa , rrjeti elektrik dhe hidraulik etj. Është parashikuar rikonstruksioni i plotë i saj si dhe ndërtimi i nyjeve hidrosanitare brënda shkollës.Gjithashtu janë parashikuar ndërtimi i terreneve sportive.

Pozicioni	Njësia Administrative Frakull , Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës.
Vlera e Veprës	19,212,736 Lekë
Afati i Punimeve	2015-2016

.....

Shkolla 9-vjeçare “Hiqmet Buzi” Kallm, Fier

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për rikonstruksion. U bë zëvendësim dyer dritare, shtresa, zëvendësim rrjeti elektrik dhe hidraulik.

Pozicioni	Njësia Administrative Mbrostar, Fier
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës
Vlera e Veprës	25,655,995 Lekë
Afati i Punimeve	18.09.2014-09.01.2015

.....

Kopësht Portëz, Fier

Kopështi ekzistues në një ambient të papërshtatshëm. Parashikohet ndërtim kopësht i ri sipas standarteve për kopshtet.

Pozicioni	Njësia Administrative Portëz. Fier
Përshkrimi Teknik	Ndërtim i ri
Vlera e Veprës	7.706.580 Lekë
Afati i Punimeve	2014-2015

Gjimnazi “18 Tetori” Lagje “Skender Libohova” Lushnje

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për rikonstruksion të plotë . U bë zëvendësim dyer dritare, shtresa, zëvendësim rrjeti elektrik dhe hidraulik, hidroizolim tarace etj. Për plotësimin e nevojave për fëmijët me aftësi të kufizuar fizike shkolla u pajis me ashensor.

Pozicioni	Bashkia Lushnje
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës
Vlera e Veprës	51,527,960 Lekë
Afati i Punimeve	16.10.20015 – 22.02.2016

.....

Shkolla 9-vjeçare Toshkëz, Lushnje

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për rikonstruksion të plotë. Çatia e shkollës paraqitej rrezik shëmbe. U bë rikonstruksioni i plotë i shkollës me sistem ngrohje punime çatie dyer dritare shtresa, punime sistemimi e terren sportive të hapura etj.

Pozicioni	Njësia Administrative Allkaj , Lushnje
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës
Vlera e Veprës	25.637.395 Lekë
Afati i Punimeve	2015-2016

.....

Shkolla 9-vjeçare “Riza Iberliu” Zhamë Sektor

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për rikonstruksion dhe shtesë kati. U bë zëvendësim dyer dritare, shtresa, zëvendësim rrjeti elektrik dhe hidraulik, sistemi i ngrohjes dhe shtesa e katit nga ku u përfituan 4 klasa të reja gjë që siguron zhvillimin e mësimin në një turn.

Pozicioni	Njësia Administrative Dushk, Lushnje
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës, sistem ngrohje dhe shtesë kati
Vlera e Veprës	28,433,206 Lekë
Afati i Punimeve	24.09.2014 – 12.11.2014 e vazhdim

.....

Ndërtim Kopësht fshati 3 Urat , Grabian, Lushnje

Kopështi ekzistues në një ambient të papërshtatshëm Parashikohet ndërtim kopësht i ri sipas standarteve për kopshtet.

Pozicioni	Njësia Administrative Grabian. Lushnje
Përshkrimi Teknik	Ndërtim i ri
Vlera e Veprës	4.431.432 Lekë
Afati i Punimeve	2014-2014

Kopësht dhe Palestër shkolla “Koli Sako” Bashkia Divjake, Lushnje

Bashkia Divjakë kishte nevojë për rikonstrukcion kopështi ekzistues dhe palestër të shkollën 9 vjeçare Koli Sako për ti kthyer në kushte normale funksionimi.

Pozicioni	Bashkia Divjakë, Lushnje
Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion kopësht dhe palestër për shkollë 9 vjeçare
Vlera e Veprës	42,591,146 Lekë
Afati i Punimeve	24.09.2015 – 12.11.2016

Shkolla e mesme Miti Zoi Zaka , Bashkia Divjakë,Lushnje

Shkolla ekzistuese kishte nevojë për palestër pasi mësimi zhvillohej vetëm në terrene jashtë. Shkolla kishte nevojë për rrethim , terrene sportive etj . U bë ndërtimi i palestrës rrethimi dhe terrenet sportive të shkollës. Gjithashtu është kryer dhe rikonstrukcioni i shkollës dyer dritare, shtresa dhe suvatime. Rikonstrukcioni është kryer në vitin 2014-2015 dhe ndërtimi i palestres dhe terreneve sportive në vitin 2015-2016.

Pozicioni	Bashkia Divjakë, Lushnje
Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion shkolle, ndërtim palestere, terrene sportive dhe rrethimi i shkollës.
Vlera e Veprës	81.237.346 Lekë
Afati i Punimeve	2014 - 2016 (dhenia e fondeve në dy faza 2014 dhe 2015)

Shkolla e mesme “Koli Allkanjari” Këmishtaj, Lushnje

Shkolla ishte e amortizuar plotësisht, taraca , dyer dritare shtresa , rrjeti elektrik dhe hidraulik etj. Është parashikuar ndërtimi i nyjeve hidrosanitare Brenda shkollës, shtesë anësore 2 kat, rrjeti i ri elektrik dhe hidraulik, sistemi i ngrohjes me kaldajë, ndërtimi i terreneve sportive si dhe sistemi i ngrohjes në shkollë.

Pozicioni	Njësia Administrative Gradisht, Lushnje
Përshkrimi Teknik	Rikonstrukcion i plote i godinës
Vlera e Veprës	65,680,320 Lekë

Afati i Punimeve 07.11.2016 – 07.07.2017

.....

Shkollë 9 vjeçare Çermë Shkumbin Bashkia Divjakë, Lushnje

Shkolla ishte e amortizuar plotësisht, taraca , dyer dritare shtresa , rrjeti elektrik dhe hidraulik etj. Është parashikuar rikonstruksioni i plotë i saj dhe shtesë anësore 2 kate si dhe ndërtimi i nyjeve hidrosanitare brënda shkollës.Gjithashtu janë parashikuar ndërtimi i terreneve sportive dhe sistemi i ngrohjes qendrore në godinë.

Pozicioni	Bashkia Divjakë, Lushnje
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës, shtese dy kate dhe sistemi i ngrohjes
Vlera e Veprës	65.340.088 Lekë
Afati i Punimeve	15.11.2016 – 07.07.2017

.....

Shkolla 9-vjeçare Panahor, Aranitas, Bashkia Mallakastër

Shkolla ekzistuese ishte në ambient të adoptuar dhe jashtë kushteve teknike për shkollë . U mendua për ndërtim shkollë të re sipas standarteve në fuqi për shkollat. Është parashikuar dhe ndërtimi i një kalçeto Brenda shkollës si dhe kënde sportive që përveç nxënësve do ti shërbejnë dhe komunitetit të zonës

Pozicioni	Njësia Administrative Aranitas, Mallakastër
Përshkrimi Teknik	Ndërtim shkollë e re me 12 klasë+ kalçeto+kënd sportiv
Vlera e Veprës	58,212,749 Lekë
Afati i Punimeve	06.10.2016 – 06.04.2017

.....

Ndërtim Kopësht Fratar , Mallakastër

Kopështi ekzistues në një ambient të papërshtatshëm. U parashikua ndërtimi i kopështit të ri me tre grupe sipas standarteve për kopshtet.

Pozicioni	Njësia Administrative Fratar. Mallakastër
Përshkrimi Teknik	Ndërtim i ri
Vlera e Veprës	8.594.244 Lekë
Afati i Punimeve	25.08.2014 -22.09.2014

.....

QARKU GJIROKASTËR

Projekti "Shkolla, qender komunitare"

Ndërtimi4 fushave sportive polifunkionale në ambientet e shkollave "Pandeli Sotiri", Shkolla "Thoma Papapano", shkolla "Çajupi" dhe shkolla "Siri Shaplo".

Ky projekt është në mbështetje të arritjes së objektit për krijimin e shkollave si qëndër komunitare për zonën ku ushtron aktivitetin si e tillë. Fushat sportive do të shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve sportive të nxënësve dhe të banorëve të zonës ku ndodhet shkolla.

Pozicioni	Bashkia Gjirokastër
Përshkrimi Teknik	Ndërtim terrene sportive
Vlera e Veprës	32,340,647 Lekë
Afati i Punimeve	2014 - 2015

Shkolla e mesme e përgjithshme "Siri Shaplo" Bashkia Gjirokastr

Shkolla ishte e amortizuar plotësisht, taraca , dyer dritare shtresa , rrjeti elektrik dhe hidraulik etj. Është parashikuar rikonstruksioni i plotë i saj , dyer dritare, shtresa, suvatime, nyje hidrosanitare dhe sistem ngrohje.

Pozicioni	Bashkia Gjirokastër
Përshkrimi Teknik	Rikonstruksion i plote i godinës
Vlera e Veprës	33.045.881 Lekë
Afati i Punimeve	2014-2015

Shkolla e mesme e përgjithshme "Abaz Shehu" Bashkia Tepelenë

Shkolla ishte e amortizuar plotësisht, dyer dritare shtresa , rrjeti elektrik, sistemi i furnizimit me ujëetj. Është parashikuar rikonstruksioni i plotë i saj , dyer dritare, shtresa, suvatime, nyje hidrosanitare, sistem ngrohje, terrene sportive dhe rrethim.

Pozicioni	Bashkia Tepelene
